

VENDIM
Nr. 431, datë 26.6.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ‘ITALIA’”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i sheshit ‘Italia’”, Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 107 402 334 (njëqind e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 107 402 334 (njëqind e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

a) fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, nga fondet e miratuara për shpronësim për Bashkinë Tiranë;

b) fondi prej 67 402 334 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga fondet e miratuara për Bashkinë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, në zyrat e Bashkisë Tiranë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ‘ITALIA’”, TIRANË**

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall m ²	Sip. truall i prekur m ²	Çmimi truall lek/m ²	Sip. totale objektit m ²	Sip. objektit e prekur m ²	Kosto e ndërtimit Obj. lek/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Shënime në kartelë
1	Shtet	“Rrugë”	8160	7/14	1,442	53	66,969				0	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
2	Shtet	“Truall”	8160	7/26	42	42	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
3	Shtet	“Truall”	8160	7/25	174	174	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
4	Shtet	“Truall”	8160	7/27	206	206	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
5	Shtet	“Trotuar”	8160	7/8	1,524	610	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
6	Shtet	“Truall”	8160	7/9	753	185	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
7	Shtet	“Shesh”	8160	7/56	3,685	3142	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
8	Bashkia Tiranë	“Truall”	8160	7/53	2,661	400	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
9	Shtet	“Truall”	8160	7/54	16,927	118	66,969				0	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
10	Shpëtim Mustafa Dama	“Truall”	8160	7/7	348	348	66,969				23,305,212	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset masa e sekuestros konservative
11	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N1	0	0		218	218.00	44,827.89	9,772,480	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
12	Bashkim Arben Burimi Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N2	0	0		218	218.00	44,827.89	9,772,480	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
13	Shpëtim Mustafa Dama	Njësi	8160	7/26/ND – N3	0	0		100	100.00	44,827.89	4,482,789	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
14	Dorjan Istref Leknikaj	Njësi	8160	7/26/ND – N4	0	0		64.8	64.80	44,827.89	2,904,847	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
15	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N5	0	0		79.1	79.10	44,827.89	3,545,886	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.05.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
16	Bashkim Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N6	0	0		79.1	79.10	44,827.89	3,545,886	shkresa nr. prot. 20/2, datë	Në seksionin “E” ka

	Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi											20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
17	Shpëtim Mustafa Dama	Njësi	8160	7/26/ND – N7	0	0		368	368.00	44,827.89	16,496,664	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
18	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N8	0	0		184	184.00	44,827.89	8,248,332	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
19	Bashkim Arben Burimi Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N9	0	0		184	184.00	44,827.89	8,248,332	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
20	Dorjan Istref Leknikaj	Njësi	8160	7/26/ND – N10	0	0		381	381.00	44,827.89	17,079,426	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin “E” ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
Totali					27,762	5,278		1,876	1,876		107,402,334		

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB-së, për qytetin e Tiranës, të miratuara me udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave, vënë në dispozicion me shkresën nr. prot. 684, datë 27.3.2018.